

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Pkl-Kzz 103/09
22 prill 2010

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë prej Gjyqtarit të EULEX-it Gerrit-Marc Sprenger si Kryetar i kolegjit, me gjyqtarët Kosovarë Avdi Dinaj dhe Emine Mustafa si anëtarë të kolegjit, dhe në prani të Edita Kusarit Këshilltare Ligjore e EULEX-it si procesmbajtëse, në lëndën penale Pkl-Kzz nr.103/09 të Gjykatës Supreme të Kosovës

Kundër:

1. të pandehurit **B. K.**, emri i të atit , emri i së ëmës mbiemri i vajzërisë i lindur më në fshatin Komuna , tani me vendbanim në , rruga Shqiptar i Kosovës, i martuar, baba i dy fëmijëve, i diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë, me gjendje të mesme ekonomike, nuk është i dënuar më parë në Kosovë, tani për tani është ende në liri,
2. të pandehurit **XH. D.**, emri i të atit emri i së ëmës mbiemri i vajzërisë i lindur më në , tani me vendbanim në Shqiptar i Kosovës, i ve, baba i tre fëmijëve, i diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë, me gjendje të mesme ekonomike,
3. të pandehurit **A. H.**, emri i të atit , emri i së ëmës mbiemri i vajzërisë Isufi, i lindur më në tani me vendbanim në rruga " Nr. 108, Shqiptar i Kosovës, i pamartuar, me gjendje të mesme ekonomike,


I pandehuri B. K. dënuar në shkallën e parë me anë të aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren, të datës 16 janar 2009, P. Nr. 874/08 për kryerje të veprës penale të

Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit, në bashkëkryerje me të akuzuarin Xhevat Danqe në kundërshtim të nenit 339 paragrafit 2 në lidhje me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK)

Është dënuar me 5 (pesë) muaj burgim,

I pandehuri XH. D. i dënuar në shkallën e parë me anë të aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren, të datës 16 janar 2009, P. Nr. 874/08 për kryerje të veprës penale të

Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit, në bashkëkryerje me të akuzuarin Bedri Krasniqi në kundërshtim të nenit 339 paragrafit 2 në lidhje me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK).



Falsifikim i dokumenteve zyrtare në kundërshtim të nenit 348 paragrafit 1 të KPK-së, Është dënuar një dënim unik me 6 (gjashtë) muaj burgim.

I pandehuri A. H. i dënuar në shkallën e parë me anë të aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren, të datës 16 janar 2009, P. Nr. 874/08 për kryerje të veprës penale të Falsifikim i dokumenteve zyrtare në kundërshtim të nenit 348 paragrafit 1 të KPK-së, Është dënuar me 3 (tre) muaj burgim,

Me Aktgjykimin e Shkallës së parë të vërtetuar në Shkallën e dytë me anë të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ap. Nr. 35/2009, të datës 02 korrik 2009,

Duke vepruar mbi Kërkesën për Mbrojtje të Ligjshmërisë të paraqitur nga Avokati mbrojtës i të pandehurit B. K. të datës 31 gusht 2009, kundër Aktgjykimeve të Gjykatës Komunale në Prizren, të datës 16 janar 2009, P. Nr. 874/08 dhe të Gjykatës së Qarkut në Prizren, të datës 02 korrik 2009, Ap. Nr. 35/2009,

Duke vepruar mbi Kërkesën për Mbrojtje të Ligjshmërisë të paraqitur nga Avokati mbrojtës i të pandehurit A. H. të datës 14 shtator 2009, kundër Aktgjykimeve të Gjykatës Komunale në Prizren, të datës 16 janar 2009, P. Nr. 874/08 dhe të Gjykatës së Qarkut në Prizren, të datës 02 korrik 2009, Ap. Nr. 35/2009,

Lëshon këtë


AKTGJYKIM

Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë e Avokatit mbrojtës të të akuzuarit, të datës 31 gusht 2009, kundër Aktgjykimeve të Gjykatës Komunale në Prizren, të datës 16 janar 2009, P. Nr. 874/08 dhe të Gjykatës së Qarkut në Prizren, të datës 02 korrik 2009, Ap. Nr. 35/2009,

Pranohet pjesërisht

siç vijon:

1. Aktgjykimet e Gjykatës së Shkallës së Parë të datës 16 janar 2009, P. Nr. 874/08 dhe të Gjykatës së Shkallës së Dytë të datës 02 korrik 2009, Ap. Nr. 35/2009 kundër të pandehurit B. K. anulohen dhe lënda kthehet për rigjykim në Gjykatën Komunale në Prizren
2. Vendimi mbi anulimin e Aktgjykimeve të Shkallës së parë dhe të Dytë dhe kthimi i lëndës në Gjykatën Komunale në Prizren për rigjykim vazhdon për të bashkakuzuarin XH. D. sipas nenit 455 paragrafit 2 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale (KPPK)
3. Zbatimi i vendimit të formës së prerë të Gjykatës Komunale në Prizren, të datës 16 janar 2009, P. Nr. 874/08, i vërtetuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren, të datës 02 korrik 2009, Ap. Nr. 35/2009 kundër të pandehurve B.



K. dhe XH. D. ndërpritet në pajtueshmëri me nenin 454 paragrafin 4 të KPPK-së.

4. Aktgjykimet të Shkallës së parë dhe të Dytë kundër të pandehurit A H mbështeten.

ARSYETIM


I. Historia e Procedurës

(I) Më 06 shtator 2007 në ndërtesën e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, i pandehuri B. K. në cilësinë e tij si Gjyqtar për konfirmim të aktakuzës ka caktuar një seancë për konfirmim të aktakuzës në lëndën penale kundër I. Q. e I. B. të akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorit Publik të Qarkut në Prishtinë të datës 19 korrik 2007, PP. nr. 855-2/07, i pandehuri I. B. për Vrasje të rëndë sipas nenit 147 paragrafit 4 të KPK-së dhe të pandehurit Q. dhe I. B. për Lëndim trupor sipas nenit 154 paragrafit 1 pikës 5 të KPK-së. Të gjithë të pandehurit dhe Avokati mbrojtës i të pandehurit I. B. si dhe përfaqësuesi ligjor i palëve të dëmtuara ishin ftuar si duhet dhe të pandehurit si dhe Avokati mbrojtës ishin të pranishëm dhe të gatshëm për shqyrtimin, gjersa përfaqësuesi i palëve të dëmtuara nuk e pa si të domosdoshme paraqitjen në Seancë për Konfirmim të Aktakuzës. Palët e dëmtuara vetë nuk janë ftuar.

Përpara fillimit të Seancës për Konfirmim të Aktakuzës, i pandehuri B. K. në cilësinë e tij si Gjyqtar për konfirmim të aktakuzës kërkoi nga të pandehurit e kësaj lënde të nresin nara zyrës së tij, kurse në praninë e avokatit mbrojtës dhe të pandehurit XH. D. që ishte prokuror përgjegjës, ai diskutoi rreth Aktakuzës dhe propozoi të ndryshohet ajo për shkak të disa zbrazëtirave dhe të metave, veçanërisht sa i përket dy të akuzuarve Qamush e Isuf Bekteshi.

Në bazë të informatave nga shkresat e lëndës, ishte përpiluar një Aktakuzë tjetër po të njëjtën ditë duke lënë përmendjen sa i përket Qamush dhe Isuf Bekteshit dhe kjo pretendohet të jetë bërë duke u bazuar në marrëveshjen në mes B. K. si Gjyqtar për konfirmim të aktakuzës dhe XH. D. si Prokuror, kurse seanca për konfirmim të aktakuzës ishte shtyrë për disa orë, derisa të bëhej gati Aktakuza e re. Po ashtu duket se nuk kishte shënime lidhur me procedurën/marrëveshjen mbi bazë të së cilës Aktakuza është kthyer në sferën e përgjegjësisë së Prokurorit.

Më vonë, duket se Aktakuza e re (që kishte datë dhe numër regjistri të njëjtë sikur e mëparshmeja) ishte vulosur dhe paraqitur në Gjykatë Komunale duke anashkaluar kështu shkrimoren e zyrës së Prokurorisë. Sipas informatave në dispozicion duket se regjistrimi i Aktakuzës së re me numër dhe datë të njëjtë si Aktakuza e mëparshme ishte i mundur për shkak të veprimit të të akuzuarit A. H. i cili me sa duket bënte zëvendësimin e referentit përkatës edhe pse pozita normale e tij ishte korrier i gjykatës.



I pandehuri B. K. si Gjyqtar për Konfirmim të Aktakuzës pastaj pranoi Aktakuzën e re, e cila tani ishte paraqitur vetëm kundër Ismail Bekteshit për Vrasje të rëndë sipas nenit 147 paragrafit 4 të KPK-së dhe e konfirmoi atë me aktvendim pas Seancës për Konfirmim të Aktakuzës të mbajtur ditën e njëjtë. Aktvendimi për Konfirmim pohohet se nuk u është dorëzuar fare Palëve të dëmtuara si dhe Përfaqësuesit të tyre ligjor.

Sidoqoftë, i pandehuri XH. D. në cilësinë e tij si Prokuror as nuk ndërpreu formalisht hetimet kundër Qamush dhe Isuf Bekteshit e as nuk njoftoi formalisht palët e dëmtuara dhe Përfaqësuesin e tyre ligjor për t'ju mundësuar atyre ushtrimin e rolit të tyre si prokuror subsidiar sipas ligjit.

Në fillimin e shqyrtimit gjyqësor, palët e dëmtuara kuptuan se Aktakuza mbi të cilin bazohet gjykimi ishte ndryshe nga ajo që kishin pranuar në kontekst të Seancës për Konfirmim të Aktakuzës, pasi që emrat e dy të pandehurve Qamush dhe Isuf Bekteshi mungonin. Në atë fazë, palët shfrytëzuan rastin për të vepruar si prokurorë subsidiarë kundër dy të pandehurve përkatës dhe Aktakuza kundër tyre u konfirmua.


(2) Më datë 04 qershor 2008. është paraqitur një Aktakuzë kundër të pandehurve B. K., XH. D. dhe A. H. (PP. Nr. 2549/08), e cila u konfirmua me aktvendim të Gjykatës Komunale në Prishtinë KA. Nr. 168/08 më 26 qershor 2008.

(3) Më 16 janar 2009, Gjykata Komunale në Prizren shpalli një aktgjykim me numër të regjistrimit P. Nr. 874/08, brenda së cilës B. K. u shpall fajtor për kryerje të veprës penale Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit, në bashkëkryerje me të akuzuarin XH. D. në kundërshtim të nenit 339 paragrafit 2 në lidhje me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) dhe u dënua me 5 (pesë) muaj burgim.

I pandehuri XH. D. i cili në kontekst përkatës ishte duke vepruar në cilësinë e tij si Prokuror i Qarkut ishte shpallur fajtor edhe për përdorim të numrit të ri regjistruar të Aktakuzës së re PP. nr. 855-2/07 sikur të numër i vërtetë dhe të vulosur e dërguar te i pandehuri B. K. në cilësinë e tij si Gjyqtar për Konfirmim të Aktakuzës. I pandehuri morri një dënim unik me 6 (gjashtë) muaj burgim, që përbëhet prej 5 (pesë) muajve për veprën penale Shpërdorim i pozitës zyrtare në kundërshtim të nenit 339 paragrafit 2 në lidhje me nenin 23 të (KPK) të kryer në bashkëpunim me të pandehurin B. K. dhe me 3 (tre) muajve "për veprën penale sikur në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi".

I pandehuri A. H. u shpall fajtor për vepër penale Falsifikim i dokumenteve zyrtare në kundërshtim të nenit 348 paragrafit 1 të KPK-së, dhe prandaj është dënuar me 3 (tre) muaj burgim.

(4) Më 24 shkurt 2009 avokati i mëparshëm i të pandehurit XH. D. paraqiti ankesë me kohë kundër Aktgjykimit të Shkallës së parë dhe propozoi që ose të lirohet i pandehuri ose të anulohet Aktgjykimi përkatës dhe lënda të kthehet në Gjykatën Komunale për rigjykim. Edhe një ankesë tjetër është paraqitur nga një tjetër Avokat



mbrojtës më 04 mars 2009, ku po ashtu kërkohet të lirohet i pandehuri apo të anulohet Aktgjykimi përkatës dhe të kthehet lënda për rigjykim.

(5) Aktgjykimi i Shkallës së parë është ankimuar me kohë nga Avokati mbrojtës i të akuzuarit B. K. . Kurse më datë 02 mars 2009 Avokati mbrojtës paraqiti ankesë duke propozuar që i pandehuri Bedri Krasniqi ose të lirohet ose të anulohet Aktgjykimi i Shkallës së parë dhe lënda të kthehet në Gjykatën Komunale për rigjykim.

(6) Avokati mbrojtës i të akuzuarit A. H. . paraqiti ankesë me kohë kundër Aktgjykimit të Shkallës së parë më 03 prill 2009 duke propozuar që i pandehuri Agim Hasani ose të lirohet ose të anulohet Aktgjykimi i Shkallës së parë dhe lënda të kthehet në Gjykatën Komunale për rigjykim.

(7) Edhe Prokuroria Komunale paraqiti ankesë me kohë më datë 20 mars 2009 dhe kërkoi dënim më të ashpër për tre të pandehurit.

(8) Më 02 korrik 2009, Gjykata e Qarkut në Prizren si Gjykatë e shkallës së dytë shpalli Aktgjykimin e vet AP. Nr. 35/2009, dhe refuzoi ankesat e paraqitura nga Avokatët mbrojtës të tre të pandehurve dhe vërtetoi tërësisht Aktgjykimin e shkallës së parë.


(9) Më 31 gusht 2009, Avokati mbrojtës i të akuzuarit B. K. . paraqiti Kërkesë për Mbrojtje të Ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës për shkelje të ligjit penal dhe shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale duke propozuar të:

- Lirohet i pandehuri B. K. .
ose
- Anulohet tërësisht Aktgjykimi i lëshuar nga Gjykata e shkallës së parë dhe i Gjykatës së shkallës së dytë dhe lënda të kthehet në Gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.

(10) Avokati mbrojtës i të akuzuarit A. H. . paraqiti Kërkesë për Mbrojtje të Ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës më 14 shtator 2009 për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal në dëm të të gjykuarit, duke propozuar të:

- Anulohet Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prizren, P. Nr. 874/08 i datës 16 janar 2009 dhe Aktgjykimi i shkallës së dytë i Gjykatës së Qarkut në Prizren, P. Nr. 35/2009 i datës 02 korrik 2009 dhe lënda të kthehet në Gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.

(11) Nuk është paraqitur Kërkesë për Mbrojtje të Ligjshmërisë në dëm të të pandehurit XH. D. .



(12) Më datë 12 prill 2010, Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPSK) paraqiti mendimin e tij duke propozuar që kërkesa e të pandehurit B. K. të

- Pranohet pjesërisht sa i përket anulimit të kërkuar të Aktgjykimit të shkallës së parë dhe urdhrin për rigjykim të kësaj lënde
- Vazhdohet vendimi i Gjykatës Supreme, sipas nenit 454 paragrafit 2 të KPPK-së sa i përket të pandehurit XH. D.

(13) Më datë 25 mars 2010 Avokati mbrojtës i të akuzuarit B. K. paraqiti një kërkesë te Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it dhe kërkoi që kjo lëndë të gjykohej nga Gjyqtarët e EULEX-it, që edhe u pranua. Asnjëri i pandehur tjetër dhe/ose Avokatët e tyre mbrojtës nuk propozoi një gjë të tillë. por me kërkesë të Gjykatës Supreme, Avokati mbrojtës i të akuzuarit A. H. e bëri të qartë përmes telefonit se kishte paraqitur një Kërkesë për Mbrojtje të Ligjshmërisë vetëm në Gjykatën Supreme dhe se nuk kishte vërejtje se kush do ta gjykonte lëndën gjyqtarët e EULEX-it apo ata Kosovarë. Ai theksoi se interesi i tij i vetëm është të merret një vendim i shpejtë dhe i duhur.

(14) I pandehuri XH. D. sipas informatave përmes bisedës telefonike me Qendrën Korrektuese përkatëse, është duke vuajtur dënimin e tij që nga data 22 shkurt 2010 në Qendrën e Paraburgimit në Pejë por momentalisht është nën kujdesin mjekësor në Qendrën Klinike Universitare të Prishtinës (Operim Vaskular) dhe i pandehuri A. H. është duke vuajtur dënimin e tij në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan që nga data 06 prill 2010, kurse i pandehuri B. K. sipas informatave në dispozicion ende nuk ka filluar të vuajë dënimin e tij.


II. Gjetjet e Gjykatës Supreme

Pavarësisht faktit se sipas nenit 457 par. 2 të KPPK-së, Gjykata Supreme e Kosovës nuk duhet të ndërhyjë në vendimin e formës së prerë të kolegjit të shkallës së dytë madje edhe nëse Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë, e paraqitur në dëm të të pandehurit, del se është e bazuar mirë, Gjykata Supreme konstaton si në vijim:

1. Pranueshmëria e Kërkesës për Mbrojtje të Ligjshmërisë

Kërkesat për Mbrojtje të Ligjshmërisë janë të pranueshme. Të dyja janë paraqitur në gjykatë kompetente sipas nenit 453 të KPPK-së dhe brenda afatit të nenit 452 paragrafit 3 të KPPK-së.

2. Procedurat e ndjekura nga Gjykata Supreme



Kolegji i Gjykatës Supreme në seancë ka vendosur siç është përshkruar në nenin 454, paragrafin 1 të KPPK-së. Palët nuk janë njoftuar për seancën, pasi që sipas nenit 460 të KPPK-së, Gjykata Supreme nuk është e obliguar që t'i njoftoj palët.

3. Mbi meritat e Kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë

a. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur në dobi të të pandehurit B. K.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është pjesërisht e bazuar.

aa. Shkeljet e pretenduara të ligjit penal

Avokati mbrojtës në kërkesën e tij për mbrojtjen e ligjshmërisë ka përmendur shkeljen e ligjit penal nga aktgjykimet e të dy shkallëve asaj të parë dhe të dytë pasi që fajësia e të pandehurit B. K. vetëm është supozuar dhe i pandehuri është dënuar për Shpërdorim të pozitës zyrtare ose të autorizimit në kundërshtim të nenit 339, paragrafëve 1 dhe 2, lidhur me nenin 23 të KPK-së

Gjykata Supreme e Kosovës gjen se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë deri më tani është e bazuar.


Neni 339, paragrafi 1 i KPK-së shkruan si në vijim:

"Personi zyrtar i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete ose për tjetrin ose për organizatën e biznesit apo të shkakimit të dëmit për personin tjetër ose për atë organizatë të biznesit shpërdoron pozitën e tij zyrtare, tejkalon kompetencat ose nuk i përmbush detyrat zyrtare dënohet me burgim deri në një vit."

Neni 339, paragrafi 2 i KPK-së shkruan si në vijim:

"Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me dëm i cili tejkalon shumën 2.500 EUR apo me shkelje të rëndë të të drejtave të personit tjetër, kryerësi dënohet me burgim deri në tri vjet. Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me dobi pasurore që tejkalon shumën 5.000 EUR, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet"

Edhe pse pa asnjë dyshim i pandehuri B. K. në cilësinë e tij si Gjyqtar për Konfirmim në lëndën përkatëse ka qenë person zyrtar në kuptim të ligjit, gjithashtu duke kryer detyrat zyrtare, tanimë është mjaft diskutabile nëse ai e ka shpërdoruar pozitën zyrtare, i ka tejkalu kufijtë e autorizimit të tij apo jo (në mënyrë të duhur) ka ekzekutuar detyrat e tij zyrtare sipas nivelit të cilësimit penal siç kërkohet me ligjin përkatës.



Nuk ka asnjë komentuar në dispozicion për vetë dispozitën përkatëse të KPK-së. Megjithatë, dispozita mbi shpërdorimin e zyrës siç është rregulluar me nenin 242 të Kodit Penal të Serbisë (KPS-së) është komentuar dhe ofron disa sqarime lidhur me çështjet në fjalë. Edhe pse sipas termit shpërdorim i zyrës, p.sh. shpërdorimi i autorizimit zyrtar nuk është uniform, është e pakontestueshme se kryerësi përkatës i pretenduar duke qenë person zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare gjithashtu duhet të veprojë kundërligjshëm dhe se aspekti penal ligjor i shpërdorimit të zyrës mund të kuptohet në mënyrë të përgjithësuar apo specifike. Pasi që në këtë rast nuk është ofruar një formë e veçantë e shpërdorimit të zyrës, e cila kërkon kryerjen e aktit penal siç përcaktohet me ligj, duhet të konsiderohet nëse mund të vërtetohet një formë e përgjithshme e shpërdorimit të zyrës apo jo. Kjo e fundit mund të konsistojë në tri alternativa, pasi që kemi (a) shpërdorim të pozitës zyrtare, (b) tejkalimin e kufijve të autorizimit dhe (c) mosekzekutimi i detyrave zyrtare (*Srentic Nikola – Ljubisa Lazarevic, Komentari i Kodit Penal të Serbisë 1995, botimi i 5-të "Savremena Administracija", Beograd, neni 242, pikët 1 deri në 3.*)

(a) shpërdorimi i pozitës zyrtare, sipas komentareve të referuar është ofruar, kur një zyrtar përfiton nga zyra ose autorizimi i tij dhe duke vepruar në kuadër të autorizimit të tij, ai ose ajo përfiton diçka për vete apo dikë tjetër ose dëmton interesat e dikujt tjetër. Përveç kësaj, nga komentaret përkatës mbi nenin 243 të KPS-së, i cil rregullon një formë speciale të shpërdorimit të zyrës, mund të kuptohet se një veprim i kundërligjshëm i një gjyqtari siç përcaktohet me ligj mund të jenë aktgjykimet, urdhrat dhe vendimet tjera të lëshuara gjatë procedurës gjyqësore, që kundërshtojnë Kushtetutën. Prandaj, dispozita bazohet në kuptimin e gjerë të termave "akt i kundërligjshëm" dhe "ligji".


Sidoqoftë, si kriter objektiv i nenit 339 të KPK-së, në këtë lëndë as aktgjykimi i shkallës së parë e as i të dytës nuk kanë vërtetuar në mënyrë të mjaftueshme se i pandehuri B. K. kishte përfutur nga pozita zyrtare siç kërkohet.

Motivimi i vetëm i të pandehurit siç është komunikuar përmes dokumenteve të dosjes ka qenë të ruajë fytyrën e tij dhe të prokurorit, në këtë mënyrë duke e mbajtur shqyrtimin tanimë të caktuar për konfirmim me një aktakuzë të amandamentuar/ndryshuar.

(b) Shkelja e autorizimit zyrtar ekziston kur një zyrtar kryen veprime zyrtare që nuk bien brenda fushëveprimit të autorizimit të tij/saj.

Në këtë lëndë, as aktgjykimi i shkallës së parë e as të dytë nuk kanë shtjelluar lidhur me pyetjen nëse dhe si i pandehuri B. K. përmes aktiviteteve përkatëse të tij ka mundur të shkelë autorizimin e tij si Gjyqtar për konfirmim, në këtë mënyrë duke vepruar jashtë kornizës së këtij autorizimi.

Nga dokumentet e dosjes mund të kuptohet se i pandehuri B. K. ka vepruar në cilësinë e tij si Gjyqtar për konfirmim mirëpo nuk ka pas ndërmend ta tejkalojë autorizimin e tij duke marrë vendime të cilat nuk janë në përgjegjësinë përkatëse.




(c) Përfundimisht, si formë e tretë e mundshme e shpërdorimit mund të konsiderohet dështimi i qëllimshëm apo i paqëllimshëm për t'i kryer detyrat zyrtare të obligueshme.

I tillë do të ishte rasti p.sh. i një zyrtari i cili nuk i aprovon aktet nënligjore të cilat është i obliguar që t'i aprovojë, apo t'i lëshojë një vërtetim një qytetari në bazë të kërkesës apo të ngjashme. Gjithashtu mund të ekzistojë kur zyrtari përkatës përfundimisht vepron mirëpo me një vonesë të gjatë që veprimi i tij i obligueshëm nuk i gjeneron më efektet e pritura ligjore.

Në këtë lëndë, i pandehuri B. K. ka kontrolluar aktakuzën e parë përkatëse dhe ka gjetur se ajo pjesërisht nuk i ka plotësuar kushtet për konfirmim. Ai e ka informuar Prokurorin dhe ka rekomanduar që aktakuza të ndryshohet në mënyrë të duhur. Të dy aktgjykimet e shkallës së parë dhe të dytë kanë vërtetuar se i pandehuri B. K., deri sa ka qenë në zyrën e tij, i ka dorëzuar dosjen Prokurorit i cili e kishte marrë prapa. Prandaj, aktakuza nuk ka kaluar përmes shkrimores së gjykatës dhe shkrimores së prokurorisë siç kërkohet. Gjithashtu, është vërtetuar se pas "ndryshimit" të aktakuzës duke i larguar dy të pandehur nga tre që ishin në fillim nuk është regjistruar përsëri në Zyrën e Prokurorit por vetëm në Gjykatë. Data dhe numri i regjistrimit nuk janë ndryshuar fare janë mbajtur të njëjtat nga aktakuza e mëparshme dhe dokumenti është vulosur. I pandehuri B. K. si Gjyqtar për konfirmim ka mbajtur seancën për konfirmim të aktakuzës në prani të të pandehurit të mbetur dhe avokatit të tij mbrojtës si dhe Prokurorit dhe përfundimisht ka konfirmuar aktakuzën e amendamentuar/ndryshuar mirëpo nuk u ka dorëzuar aktvendimin mbi konfirmim palëve të dëmtuara dhe përfaqësuesve të tyre ligjor

Në këtë fazë Gjykata Supreme duhet të lërë të hapur se a i plotëson standardet e sjelljes penale apo jo mënyra e përshkruar se si është marrë me dosjen i pandehuri B. K. Në këtë kontekst duhet të konsiderohet se Gjyqtari së paku ka treguar një ngurrim serioz kur është marrë me çështjen. Kjo pretendohet se është bazuar në shprehitë e zakonshme të këqija në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë dhe gjithashtu ndoshta në marrëdhëniet kolegjiale të kahershme me prokurorët. Si rezultat i faktit se dokumenti përkatës nuk është regjistruar në mënyrë të duhur, kur është larguar nga Gjykata, ka hyrë në Zyrën e Prokurorisë dhe është kthyer prapa duke shkaktuar konfuzitet të madh lidhur me verifikimin e dokumenteve dhe transparencën në veprimet e Gjykatës.

Për më tepër, i pandehuri B. K. në cilësinë e tij të Gjyqtarit për konfirmim asnjëherë nuk e ka përmbush obligimin e tij për ti dorëzuar palëve të dëmtuara dhe përfaqësuesve të tyre ligjor aktakuzën e amendamentuar/ndryshuar dhe në këtë mënyrë ka shkaktuar që këta të fundit mos të jenë të njoftuar lidhur me të drejtat e tyre për të vepruar si paditës subsidiarë kundër dy të pandehurve Q. dhe J. B.



Vetëm sjellja e fundit e të pandehurit B. K. mund – në rrethana të caktuara - të konsiderohet si veprim relevant në kuptimin e nenit 339, paragrafit 1 të KPK-së sa i përket mosekzekutimit të detyrave zyrtare.

Sidoqoftë, në këtë fazë nuk ka nevojë që çështje e lartpërmendur të vendoset menjëherë, pasi që ajo që kryesisht është në pikëpyetje për të pandehurin B. K. është *mens rea* siç është treguar më vijim. Në cilindo rast, sjellja e të pandehurit B. K. së paku mund të jetë një çështje për tu shqyrtuar nga organet disiplinore.


Subjektivisht, neni 339, paragrafi 1 i KPK-së kërkon qëllimin e kryerësit për përfitim të kundërligjshëm për vetën apo ndonjë person tjetër apo organizatë afariste apo t'i shkaktojë dëme ndonjë personi tjetër apo ndonjë organizatë afariste. Qëllimi i nevojshëm mund të jetë vetëm *dolus directus* ose *dolus specialis*.

Në këtë lëndë, siç është cekur edhe më lart, çështje kryesore diskutabile është ajo e *'mens rea-së* së lëndës. As aktgjykimi i shkallës së parë e as të dytë nuk e kanë vërtetuar në mënyrë të mjaftueshme se për çfarë ishte qëllimi i të pandehurit B. K.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e tij në aktgjykim ka përfunduar “se në veprimet e të akuzuarve XH. D. dhe B. K. janë krijuar të gjitha elementet e veprës penale Shpërdorim i detyrës zyrtare në bashkëpunim sipas nenit 339, paragrafit 2, lidhur me nenin 23 të KPPK-së” (f. 9 e përkthimit në anglisht). Përveç kësaj, ka gjetur se lidhur me argumentet e mbrojtjes sipas të cilave veprimet e të dy të pandehurve janë më tepër shkelje profesionale kryesisht të arsyetueshme me mbingarkesën e punëve në gjykatë dhe prokurori, “gjykata nuk i ka besuar atyre dhe të njëjtat janë refuzuar si tendencë që kanë për qëllim shmangien e përgjegjësisë penale-juridike” f. 10 e (përkthimit në anglisht).

Gjykata Komunale nuk e lëshon asnjë fjalë për qëllimin e të pandehurve. Lidhur me këtë vlen të përmendet se në mënyrë statistikore ndjekja private dhe subsidiare janë shumë më pak të suksesshme se ndjekja shtetërore. Prandaj, duke i pyetur palët e dëmtuara të cilat nuk kanë pasur njohuri lidhur me aktakuzën e ndryshuar deri sa për të kanë mësuar gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe deri në atë kohë ata kanë qenë të privuar nga e drejta e tyre për të vepruar si paditës subsidiarë kundër dy të pandehurve të tjerë, mund të jenë të dobishme sikurse edhe informacionet mbi rezultatet e gjykimit kundër dy të pandehurve Q. dhe I. B.

Gjithashtu aktgjykimi i shkallës së dytë i është referuar dhe ka përmendur se të pandehurit janë shpallur fajtorë, “pasi që gjykata ka konfirmuar se të pandehurit XH. D. dhe B. K. me anë të veprimeve të tyre të përhashkëta me qëllim të shkeljes së rëndë të së drejtave të palëve të dëmtuara, kanë shpërdoruar pozitën e tyre zyrtare...” (f.9 e përkthimit në anglisht).



Përfundimisht, duhet theksuar se gjykata e shkallës së parë duke qenë e vërtetuar nga gjykata e shkallës së dytë ka dënuar të pandehurin B. K. për Shpërdorim të pozitës zyrtare sipas nenit 339, paragrafit 2 të KPK-së, e cila është cilësim i paragrafit 1.

Sidoqoftë, nuk ka qenë e vërtetuar në mënyrë të mjaftueshme se aktivitetet e pandehurit kanë rezultuar në dëm që tejkalon shumën prej 2.500 Euro ose në shkelje të rëndë të të drejtave të ndonjë personi tjetër (këtu me siguri të palëve të dëmtuara). Siç mund të lexohet nga komentaret e (*Srentic Nikola – Ljubisa Lazarevic, KOmentari i Kodit Penal të Serbisë 1995, botimi i 5-të, "Savremena Administracija", Beograd, neni 242, pika 4.*), nuk ka definicion të qartë kur shkelja e të drejtave cilësohet si "e rëndë" e cila – duke qenë çështje faktike – duhet të vlerësohet prej rastit në rast. Aktgjykimet e kundërshtuara nuk i kanë shtjellimet e tilla fare. Në këtë kontekst gjithashtu mund të merret parasysh se palët e dëmtuara përfundimisht gjatë shqyrtimit gjyqësor kanë mësuar lidhur me faktin se dy prej fillimisht tre të pandehurve nuk janë ndjekur fare deri më tani. Ata menjëherë e kanë shfrytëzuar mundësinë për të vepruar si paditës subsidiarë dhe si rezultat kanë paraqitur një aktakuzë e cila është konfirmuar dhe në ndërkohë gjithashtu ka përfunduar në shqyrtim gjyqësor. Këtu gjithashtu mund të jetë e dobishme të konsiderohen rezultatet e ndjekjes së të pandehurve përkatës Q. dhe I. B. dhe – varësisht nëse ata janë dënuar apo liruar – të shtjellohet mbi arsyet e vendimeve përkatëse të gjykatës.

bb. Shkelja e pretenduar e nenit 403 par. 1 nën-par. 10 të KPPK-së

Nuk ka shkelje të nenit 403 par. 1 nën-par. 10 të KPPK-së/KPPK-së.

Avokati mbrojtës në kërkesën e tij për mbrojtjen e ligjshmërisë ka theksuar se aktgjykimi i shkallës së parë duke e ri-cilësuar veprën e aktakuzës nga Nxjerrje e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore sipas nenit 346 të KPK-së në Shpërdorim i pozitës zyrtare sipas nenit 339 të KPK-së ka tejkaluar aktakuzën sa i përket nenit 386, paragrafit të KPPK-së.

Gjykata Supreme e Kosovës gjen se kushtet e nenit 386 të KPPK-së për tejkalimin e aktakuzës nuk janë përmbushur nga gjykata e shkallës së parë.

Paragrafi 1 i dispozitës përkatëse shkruan si në vijim:

"Aktgjykimi mund t'i referohet vetëm personit të akuzuar dhe vetëm veprës që është objekt i akuzës të përfshirë në aktakuzën e paraqitur fillimisht, të ndryshuar ose të zgjeruar në shqyrtimin gjyqësor".

Ndryshe nga kjo, paragrafi 2 i dispozitës përkatëse shkruan:

"Gjykata nuk detyrohet me propozimet e paditësit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës".



Duke u bazuar në këtë, natyra e këtij ligji mund të kuptohet qartazi si kufizim i gjykatës përkatëse ndaj këtij akti, që do të thotë veprimet duhet të përcaktohen nga aktakuza si lëndë e akuzës. Megjithatë, gjykata është e lirë të bëjë rikualifikimin e kualifikimit ligjor të këtyre veprave duke i përmbushur kushtet e dispozitës së veprës penale të caktuar të ndryshme nga ajo që prokurori ka përkufizuar në aktakuzë.

Gjykata Komunale në Prizren në aktgjykimin e saj ka vënë në pah se edhe pse "sipas aktakuzës i akuzuari B. K. është akuzuar për kryerjen e veprës penale nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore në pajtim me nenin 346 të KPPK-së, prej situatës së vërtetuar faktike dhe të dëshmive të nxjerra kjo Gjykatë nuk ka vërtetuar që në veprat e tij janë plotësuar elementet e veprës penale e cila i është vënë në barrë ..." por që "në veprat e të akuzuarit (janë plotësuar kërkesat) e veprës penale të Shpërdorimit të Pozitës Zyrtare në pajtim me nenin 339 paragrafi 2 në lidhje me nenin 23 të KPPK-së" (fq. 10 e përkthimit në gj. angleze).

Arsyetimi tregon qartë se gjykata e shkallës së parë ka zbatuar nenin 386 paragrafi 2 të KPPK-së dhe kështu ka vendosur në pajtim me kërkesat e ligjit për ri-cilësimin e veprës në fjalë në dallim prej aktakuzës. Prandaj, Gjykata Supreme e ndan mendimin siç është vënë në pah nga gjykata e shkallës së dytë që "aktakuza nuk është tejkualuar në kuptim të shkeljes në përputhje me dispozitat e nenit 403, paragrafit 1, nën-paragrafit 10 të KPPK-së".


cc. Shkeljet e pretenduara të nenit 403, paragrafit 1, nën-paragrafit 12 të KPPK-së

Avokati mbrojtës gjithashtu ka theksuar se aktgjykimi i shkallës së dytë në brendi është kontradiktor dhe logjikisht i pakuptueshëm kur kemi të bëjmë me arsyetimin mbi interpretimin e drejtës materiale të veprave të të akuzuarit B. K. në kërkesat e ligjit penal.

Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka gjetur asnjë shkelje në lidhje me nenin 403 paragrafi 1, nën-paragrafi 12 të KPPK-së siç është theksuar nga avokati mbrojtës.

(a) Në lidhje me ri-cilësimin e veprave të të pandehurit B. K. si Shpërdorimi i Pozitës Zyrtare apo Autoritetit në kundërshtim të nenit 339, paragrafit 1 të KPPK-së, Gjykata e Qarkut në Prizren ka theksuar:

"... shkelja e ligjit nga gjyqtari paraqet Shpërdorimin e Pozitës Zyrtare apo Autoritetit në pajtim me nenin 339, paragrafi 1 të KPPK-së dhe përbën elemente të njëjta vendimtare për përfitimin personal apo duke i shkaktuar dëm të tjerëve, derisa kryesi i veprave të tilla penale është vetë person zyrtar. Kështu, duke pohuar se i pandehuri B. K. është shpallur fajtor si bashkë-kryes me të pandehurin XH. D. bazuar në faktet që janë vërtetuar në shqyrtimin gjyqësor, nuk do të thotë detyrimisht që Aktgjykimi ka tejkualuar fushëveprimin e akuzës" (fq.8 e versionit në gjuhën angleze).



(b) Sa i përket kualifikimit të veprave të të dy të pandehurve, **B. K.** dhe **XH. D.** duke ndërruar përmbajtjen e aktakuzës së mëparshme duke hequr dy nga fillimisht tre të pandehur, gjykata e shkallës së dytë ka theksuar:

*“Largimi i dy të pandehurve të tjerë nuk është realizuar nga tërheqja e ndjekjes penale të të pandehurit – Prokurorit Publik të Qarkut **XH. D.** dhe përveç kësaj, pala e dëmtuar nuk është këshilluar të vazhdojë me ndjekje penale si paditës subsidiar, d.m.th.: duke i larguar dy të pandehurit nga aktakuza si me datën 06 shtator 2007, kur aktakuza është përmirësuar dhe kur Gjyqtari i konfirmimit – i pandehuri **B. K.** nuk i ka këshilluar palët e dëmtuara deri me 08 nëntor 2007 lidhur me të drejtat e tyre që si paditës subsidiarë mund të vazhdojnë me ndjekjen penale kundër dy të pandehurve të tjerë të cilët ishin shfaqësuar prej aktakuzës” (fq. 7 të versionit në gjuhën angleze).*

Edhe pse formulimi, e posaçërisht siç është cituar nën (b), do të duhej të bëhej me një gjuhë më të mirë dhe më të qartë, qëllimi i gjykatës është i qartë dhe lehtë kuptohet. Arsyetimi – përkundër pyetjes nëse është apo nuk është, është i saktë në kushtet e interpretimit të drejtës penale materiale – posaçërisht nuk është kontradiktor apo jologjik.


b. Situata e të drejtave të të pandehurit Xhevat Danqa:

Edhe pse asnjë kërkesë për Mbrojtjen e Ligjshmërisë nuk është parashtruar në favor të të pandehurit **XH. D.**, Gjykata Supreme gjen se të njëjtat arsye për vendosje në favor të të pandehurit **B. K.** gjithashtu ekzistojnë në lidhje me të pandehurin **XH. D.** dhe kështu në pajtim me propozimin e ZPSHK-së zbaton nenin 455, paragrafi 2 të KPPK-së. Kështu që, i pandehuri **XH. D.** duhet të trajtohet gjithashtu sikur ai me kohë ka parashtruar kërkesë për Mbrojtje të Ligjshmërisë.

aa. Shkelja e ligjit penal dhe shkelja përmbajtjesore e procedurës penale si në bashkë-kryerjen e pretenduar me të pandehurin **B. K.:**

Sa i përket që i pandehuri **XH. D.** është shpallur fajtor për Shpërdorim të Pozitës Zyrtare apo Autoritetit në bashkë-kryerje me të pandehurin **B. K.** në kundërshtim të nenit 339 në lidhje me nenin 23 të KPK-së, Gjykata Supreme e Kosovës i referohet plotësisht shqetësimeve të cilat janë vënë në pah në lidhje me përfshirjen e pretenduar penale të të pandehurit **B. K.** Sipas aspekteve të lartpërmendura gjithashtu dëshmitë dhe cilësimi ligjor në lidhje me të pandehurin **XH. D.** duhet të shqyrtohet përsëri.

Në këtë kontekst dhe në lidhje me detyrat e të pandehurit **XH. D.** si prokuror duhet gjithashtu të fokusohet në faktin që pothuajse të gjitha sistemet ligjore kontinentale Evropiane e njohin parimin e ndjekjes penale të obligueshme. Prandaj, si



pyetje logjike është detyrë e prokurorit të informojë palët e dëmtuara lidhur me tërheqjen (e pjeshme) të aktakuzës me qëllim që t'ja mundësojë atyre që të veprojnë si paditës subsidiarë.

c. **Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë e parashtruar në favor të të pandehurit A. H. :**

aa. **Shkelje përmbajtësore e procedurës penale:**

Avokati mbrojtës i të pandehurit A. H. në kërkesën e tij për Mbrojtje të Ligjshmërisë ka theksuar se aktgjykimet e shkallës së parë dhe të dytë në mënyrë përmbajtësore kanë shkelur nenin 403, paragrafi 1, pika 12 të KPPK-së, pasi që Gjykatat nuk e kanë konsideruar që veprimet teknike përkatëse të të pandehurit do të paraqesin parregullsi ligjore në lidhje me regjistrimin e aktakuzës së përmirësuar dhe se gabime të tilla teknike shumë lehtë mund të korrigojnë sipas nenit 397, paragrafi 1 dhe 2 të KPPK-së.


Nuk është gjetur asnjë shkelje përmbajtësore e procedurës penale.

Gjykata Supreme e Kosovës gjen se neni 397 i KPPK-së në mënyrë të qartë i referohet gabimeve e cila përfshin kërkesat e ligjit që gabimet përkatëse mund të jenë kryer nga një lloj i pakujdesisë.

Në rastin konkret është e padiskutueshme që i pandehuri A. H. qëllimisht ka vulosur aktakuzën e përmirësuar me vulën e gjykatës por e ka vendosur datën dhe numrin e regjistrimit të aktakuzës së mëparshme. I pandehuri gjithashtu ka ditur përmes korrierit të gjykatës të Prokurorisë së Qarkut në Prishtinë që ekzistonte një gabim në aktakuzë që ishte korrigjuar dhe do të duhet ishte regjistruar me të njëjtën datë. I pandehuri A. H. e ka regjistruar aktakuzën e ndryshuar në Shkrimore të Gjykatës duke përdorur kështu datën e vjetër dhe vulën e gjykatës.

Në këtë kontekst në veçanti duhet të njoftohet që data e aktakuzës i referohet 04 qershor 2006, derisa veprimet përkatëse janë marrë nga i pandehuri me 06 shtator 2006. Do të ishte larg prej çfarëdo lloji të përvojës jetësore të besohet që i pandehuri nuk ishte në dijeni për këtë.

Ndonëse ky aspekt i vetëm në të vërtetë mund të bazohet në gabimin e pastër në të shkruar apo të shtypur, është shumë vështirë që në të njëjtin dokument gjithashtu që gabimisht të përdoret përsëri numri i regjistrimit të aktakuzës së mëparshme. Veç kësaj, deklarata e dëshmitares, zyrtares së zyrës së pranimi në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë B. K. të datës 03 dhjetor 2008 e dhënë para Gjykatës Komunale në Prizren, ofron disa sqarime për lëndën. Dëshmitarja në një kontekst posaçërisht ka theksuar se i pandehuri A. H. është një prej tre dorëzuesve të letrave në gjykatë, i cili "zakonisht e zëvendëson" atë, që në ditën përkatëse ishte zëvendësues për shkak të faktit që ajo ishte e sëmurë. Prandaj, nga kjo kuptohet që i pandehuri –edhe pse i pa trajnuar sa duhet për punën – nuk i ka përmbushur për së



pari detyrat e nëpunësit të shkrimores dhe me këtë do të ketë ditur se çka është duke bërë.

Prandaj, Gjykata Supreme gjen se aktgjykimet e shkallës së parë dhe të dytë nuk kanë shkelur procedurën penale nga jo-konsiderata e nenit 397 të KPPK-së.

bb. Shkelja e ligjit penal:

Avokati mbrojtës gjithashtu theksoi që veprimet e të pandehurit A. H. "nuk do të mund të paraqesin elemente të veprës penale për të cilat ai është gjykuar" (e që është Falsifikimi i Dokumenteve Zyrtare në kundërshtim me nenin 348, paragrafi 1 të KPK-së), pasi që ai ka gjeneruar vetëm gabim teknik që sipas ligjit mund të korrigjohet. Në veçanti nuk do të ishte e mundur të "thuhet me siguri të plotë që (i pandehuri) ka kryer veprë penale të falsifikimit, pasi që prokurori është ai që është në zotërim të aktakuzës ndërsa gjyqtari i procedurës paraprake është përgjegjës për vendimet e miratuara në procedurë".

Gjykata Supreme gjen se nuk ka shkelje të ligjit penal siç është pretenduar nga avokati mbrojtës.


Neni 348, paragrafi 1 të KPPK-së thotë siç vijon:

"Personi zyrtar ose personi përgjegjës i cili në dokumentin zyrtar ose afarist, në regjistër zyrtar ose në shkresë shënon informacion të rremë ose nuk shënon informacionin thelbor apo me nënshkrimin e tij ose me vulën zyrtare vërteton dokumentin zyrtar a afarist, vërteton regjistrin zyrtar ose shkresën e cila përmban të dhëna të rreme ose mundëson përpilimin e dokumentit, regjistrin ose shkresës së tillë me përmbajtje të rreme dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet".

Edhe pse mund të jetë e diskutueshme nëse i pandehuri A. H. i cili është i punësuar si dorëzues i dokumenteve në gjykatë, ishte duke vepruar si "person zyrtar" në kuptim të ligjit, kur ai ishte duke zëvendësuar nëpunësen e shkrimores së gjykatës dhe kështu ka vazhduar me aktakuzën në fjalë në mënyrën e përshkruar, shkon pa u thënë se ai gjatë asaj kohe ishte "personi përgjegjës". Kjo bëhet e qartë më vonë duke marrë parasysh faktin se sipas deklaratës përkatëse të dëshmitares së nëpunëses së shkrimores, B. K., i pandehuri së bashku me dy persona tjerë zakonisht e zëvendësonin nëpunësen e shkrimores së gjykatës sa herë që ajo mungonte.

I pandehuri gjithashtu ka shkruar në aktakuzën e përmirësuar të prokurorit, e cila pa dyshim është dokument zyrtar, datën e lëshimit dhe numrin e regjistrimit i cili në kombinim i përkiste aktakuzës së mëparshme të së njëjtës lëndë. Ai kështu ka regjistruar informacion të pavërtetë në dokument dhe ka përmbushur kushtin e kërkuar të ligjit përkatës.

Ai pastaj më vonë ka vulosur aktakuzën me vulën zyrtare të gjykatës dhe kështu ka përmbushur kushtin alternativ përkatës të ligjit përkatës.



Tashmë është shtjelluar më parë se përveç që është larg cilitdo lloj përvoje jetësore për të besuar që i pandehuri ka mundur të mos jetë në dijeni të datës aktuale, e që ishte 06 shtator 2006, në vend të datës ka vendosur në aktakuzë, e që ishte 04 qershor 2006. Pasi që ai gjithashtu ka vendosur numrin e regjistrimit të aktakuzës së mëparshme përkatëse mund të përjashtohet që data e gabueshme është e bazuar vetëm në gabim daktilografie. Prandaj, Gjykata Supreme është e bindur që i pandehuri ka vepruar me qëllim brenda formës së *dolus directus*.

Përfundimisht, si në dënimin e shqiptuar prej 3 (tre) muajsh burgim, duhet të theksohet që gjykata e shkallës së parë dhe të dytë tashmë ka vendosur për dënimin më të ultë të mundshëm kështu duke e marr parasysh rolin e reduktuar dhe përgjegjësinë e të pandehurit në tërë kontekstin përkatës.

5. Ndërprerja e zbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë:

Ndërprerja e zbatimit të gjitha vendimeve të Gjykatës Komunale dhe të Qarkut në Prizren kundër të gjithë të pandehurve përkatës është urdhëruar në pajtim me nenin 454, paragrafi 4 të KPPK-së për shkak të faktit që është i nevojshëm shqyrtimi i sërishëm i dëshmive dhe cilësimi ligjor.

III. Konkluzioni i Gjykatës Supreme të Kosovës

Për shkak të arsyeve të lartpërmendura, Gjykata Supreme përfundon se Kërkesa për Mbrojtjen e Ligjshmërisë është pjesërisht e bazuar. Prandaj, aktgjykimet përkatëse janë prishur dhe janë kthyer në Gjykatën Komunale të Prizrenit si gjykatë e shkallës së parë për ri-gjykim.

Për shkak të kësaj, zbatimi i aktgjykimeve ndërpritet deri në vendimin e formës së prerë.

Si pasojë, Gjykata Supreme e Kosovës vendos mbi kërkesat përkatëse për Mbrojtje të Ligjshmërisë si në dispozitiv, në pajtim me nenin 457, paragrafi 1, pika 2 të KPPK-së.


GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
Pkl-Kzz I03/09, 22 prill 2010

Anëtar i kolegjit

Avdi Dinaj

Procesmbajtëse

Edita Kusari



Anëtare e kolegjit

Emine Mustafa

Kryetar i kolegjit

Gerrit-Marc Sprenger

Republika e Kosovës

Republika Kosovo

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćení radnik